



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

Njësia e Prokurimit

Gjilan, me datë: 19.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjilanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1.1 pika (a) të lidhur me nenin 62.1 pika (a) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim të dt. 15.09.2023 të parashtruar nga: **OE SHPK "IZO-H"** "lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës " Hamdi Kurteshi " - Gjilan Ri Tender ", me nr.identifikues 651-23-9254-5-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 037 511, mori këtë:

VENDIM

- I. **HEDHET E JASHTAFATSHME** Kërkesa për rishqyrtim e Operatorit Ekonomik "SHPK "IZO-H", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës " Hamdi Kurteshi " - Gjilan Ri Tender " , me nr.identifikues 651-23-9254-5-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 037 511 të datës 30.08.2022 kundër DT dhe Njoftimit për Kontratë - të datës 30.08.2022 të publikuar në platformën e prokurimit elektronik, inicuar nga AK Komuna e Gjilanit.
- II. **VËRTETOHET** Publikimi i Njoftimit për Kontratë dhe AK do të vazhdojë sipas Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për Kontratë të datës 31.08.2023.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik SHPK "IZO-H". si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ar sy e t i m

Operatori Ekonomikë 'SHPK' " IZO-H ", me datë 15.09.2023, kan parashtruar kërkesat e tyre për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zgjerimi i rrugës " Hamdi Kurteshi " - Gjilan Ri Tender " me nr.identifikues 651-23-9254-5-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 037 511. Autoriteti Kontraktues me datë 18.09.2023 ka shqyrtuar kërkesat në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit dhe analizimit të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga SHPK " IZO-H ", Autoriteti Kontraktues - Kuvendi Komunal Gjilan ka konstatuar se pretendimet e juaja janë të pa bazuara në lidhje me pretendimet e juaja :

Pretendimi nr. 1 :

Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit ka përcaktuar kritere diskriminuese të cilat edhe pse janë të lejuara me Ligjin e Prokurimit Publik, të njëjtat nuk rekomandohet të përdoren pasi që ulin konkurrencën në mesin e operatorëve ekonomik. Fjala është për: (i). Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare - ku është kërkuar që operatorët në rast të konsorciumit, lideri të plotësoj 60% të kërkesave për qarkullim, pasi që në kërkesën nr.1 thuhet: "Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2020-2021-2022) ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 3,500,000.00 €. Në rast grupi, lideri i grupit duhet ti plotësoj min.60% të vlerës së kërkuar." Një kërkesë e tillë e ngjashme është përcaktuar edhe në pjesën e Kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/apo financiare ku është kërkuar: "Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme me natyrën e aktivitetit ne 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë), ne vlere minimale prej 3,000,000.00 €,ku prej tyre duhet te këtë se paku nje Kontrate apo reference në lëmin e rregullimit të shtretërve të lumenjëve ose kolektorëve."

Të dy këto kërkesa e ulin konkurrencën dhe numrin e operatorëve ekonomik të cilët mund të plotësojnë kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, andaj si të njëjta bien në kundërshtim me Nenet 6 dhe 7 të Ligjit të Prokurimit Publik. Po ashtu referencat nuk mund të kërkohen në projekte specifike, por ato mund të jenë të natyrës së kontratës dhe kjo përcaktohet pastaj nga lloji i punëve të cilat janë kryer nga operatori, pavarësisht emrit specifik të kontratës, nëse ka qenë apo jo për rregullimin e shtretërve të lumenjve, apo punë të ngjashme, siç mund të jenë kanalet e ujitjes, dhe punë të tjera të natyrës së kontratës.

Përgjigjia e AK lidhur me këto pretendim është se :

Sa I përket Kërkesës së Parë, ju Njoftojmë se AK ka vendosur Kërkesat në harmoni që janë nevojshme për këtë aktivitet duke u bazuar me nenin 27.4 të RROUPP me nr. 001/2022. Pasi që ky aktivitet është me vlerë të madhe atëherë Komuna ka vlerësuar se lideri i grupit duhet të plotësojë këtë kriter.

AK ka vlersuar se për realizimin e kësaj kontrate është të nevojshme kërkesa në fjalë.

Autoriteti Kontraktues (AK) - në harmoni me Nenin 1 Qëllimi, Nenin 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti dhe Nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ka hartuar DT duke specifikuar kriteret të cilat nuk e kufizojn konkurrencën nuk diskriminon kundër ose vepron në favor të ndonjë OE.

Autoriteti Kontraktues ,me rastin e vendosjes se kerkesave te nenit 68 ne FTD , per % se kerkuar nga lideri grupit ka veprua ne harmoni me neni 26.10 te Rregullores per Prokurim Publik dhe Udhezuesin Operativ per Prokurim Publik ,konkretisht sipas pikes iii. Shënim për kërkesat e aftesise teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se): ,ku ky nen thot: po e citoj nenin 26.10 Kur është e nevojshme, autoritetet kontraktuese mund të përcaktojnë në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë se si grupet e Operatorëve ekonomik duhet të përmbushin kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare ose aftësinë teknike dhe profesionale të referuar në nenin 68 dhe 69 të LPP-se, ku AK-se mund të përcaktojnë një përqindje minimale në drejtim të plotësisimit të kërkesave nga lideri i grupit të OE. Si dhe ne perputhje me Udhezuesin Operativ per Prokurim Publik ,konkretisht sipas pikes iii. Shënim për kërkesat e aftesise teknike dhe/ose profesionale (neni 69 i LPP-se):

Shembull:

Qarkullimi minimal i kërkuar nga AK është 2,000,000 euro dhe AK, mund të përcaktoj ne Njoftimin për kontrate se lideri i grupit preferohet të përmbush se paku 51% e këtij qarkullimi minimal.

- Faktet dhe rrethanat e rastit –

Kundër këtij vendimi, OE ankues “IZO-H” SHPK me datën 15.09.2023 ka parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK – Komunës së Gjilanit, që i bie jashtë afatit ligjor të paraparë me LPP dhe RRPP.

Operatori Ekonomik ankues “IZO-H” SHPK, ka qenë i obliguar që kërkesën për rishqyrtim ta parashtrorë dhe dërgojë në AK para skadimit të afatit ligjor për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim në pajtim me nenin 60 në paragrafin 1 pika (a) dhe paragrafin 2 lidhur të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik.

Neni 60 në paragrafin 1 pika (a) i rregullorës përcakton se: *a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK 134 AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore).*

Neni 60 në paragrafin 2 i rregullorës përcakton se: *“Është përgjegjësi e parashtruesit të kërkesës për rishqyrtim që kërkesa të përgatitet dhe dërgohet në autoritet kontraktues para skadimit të afatit të fundit për parashtrim të kërkesës për rishqyrtim...”*

- Përfundim -

Mbi bazën e fakteve dhe rrethanave faktike dhe juridike të shpjeguara si më sipër, kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar në AK – Komunën e Gjilanit nga OE ankues “Izo-H” SHPK, për aktivitetin e prokurimit “Zgjerimi i rrugës ” Hamdi Kurteshi ” - Gjilan Ri Tender “ me nr.identifikues 651-23-9254-5-1-1 dhe numër të brendshëm i prokurimit: GL 651 23 037 511., është e jashtëafatshme sepse nuk është parashtruar brenda afateve ligjore për paraqitjen e saj. Dhe për këtë përgjegjësia e dështimit mbetet tek parashtruesi i kërkesës.

Prandaj, kërkesa për Rishqyrtim e OE ankues “IZO-H” SHPK, si e tillë hedhet si e jashtëafatshme dhe nuk hyn në shqyrtim meritor nga AK – Komuna e Gjilanit.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, Autoriteti Kontraktues përmes Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit në kuptim të nenit 108/A në paragrafin 10.1 të LPP-së dhe nenit 63 paragrafi 1.1 pika (a) të lidhur me nenin 62.1 pika (a) të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.


Kujtim Bajrami
Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit



Kopje:

- Operatorit Ekonomik;
- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Te gjitha palëve të interesuara;